



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3168/2 prot.,

Datë 22.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur” me nr. REF- 85061-10-24-2023 me objekt: *“Rikonstruksion, modernizim i reparteve / magazinave të HSH”*, me fond limit 37,138,483.26 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 14.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Hekurudha Shqiptare sh.a.

Ankimues: “SARDO” SHPK me NIPT K13120402Ë dhe adresë Lagjia Apollonia, Rruga Jakov Mile, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurie 3/5-N12, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Hekurudha Shqiptare sh.a. me adresë Rr. Egnatia, Lagjia nr.3, Durrës.

Në datën 21.12.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3695 dhe protokolluar me nr. 3168/2023 prot., datë 21.12.2023 e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SARDO” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*,

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “SARDO” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Në pikën 2.3.11 të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar

Studio e projektimit

Të jetë e pajisur me Licensë Projektimi dhe të ketë të përfshirë si drejtues Teknik në licensë

- Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturë - 1 (një)

- Inxhinier Topograf - 1 (një)

- Inxhinier Elektrik -1 (një)

- Inxhinier Mekanik -1 (një)

Studio e projektimit duhet të ketë një punësim jo më pak se 10 (dhjetë) punojësish , të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum, muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar.

Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Operatori nuk ka paraqitur listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 22.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri